



**HAL**  
open science

## Çështja e Kosovës dhe Diplomacia Ndërkombëtare (1991-1999): Një konflikt i parashikueshëm

Enika Abazi

► **To cite this version:**

Enika Abazi. Çështja e Kosovës dhe Diplomacia Ndërkombëtare (1991-1999): Një konflikt i parashikueshëm. *Studime Historike*, 2012, 66 (3-4), pp.187-216. halshs-01202101

**HAL Id: halshs-01202101**

**<https://shs.hal.science/halshs-01202101>**

Submitted on 22 Sep 2015

**HAL** is a multi-disciplinary open access archive for the deposit and dissemination of scientific research documents, whether they are published or not. The documents may come from teaching and research institutions in France or abroad, or from public or private research centers.

L'archive ouverte pluridisciplinaire **HAL**, est destinée au dépôt et à la diffusion de documents scientifiques de niveau recherche, publiés ou non, émanant des établissements d'enseignement et de recherche français ou étrangers, des laboratoires publics ou privés.

# STUDIME HISTORIKE

3 - 4

ENIKA ABAZI

## ÇËSHTJA E KOSOVËS DHE DIPLOMACIA NDËRKOMBËTARE (1991-1999): NJË KONFLIKT I PARASHIKUESHËM

Që prej momentit të shpërbërjes së Jugosllavisë një sërë parimesh dhe normash që konsiderohen të rëndësishme për ruajtjen e rendit ndërkombëtar dhe paqen rajonale duket se kanë ndikuar politikat e ndjekura dhe masat e aplikuara nga diplomacia ndërkombëtare ndaj çështjes dhe më vonë pavarësisë së Kosovës<sup>1</sup>. Shkaqet e brendshme të konfliktit duket se janë lënë në plan të dytë në kuptimin dhe trajtimin e rastit të Kosovës. Zgjidhjet e ofruara nga diplomacia ndërkombëtare për shpërbërjen e Jugosllavisë të frymëzuar nga parimi ndërkombëtar i *uti possidetis*<sup>2</sup> dhe parimi i sovranitetit territorial u sfiduan nga konflikti për vetëvendosje në Kosovë. Praktikrat e ndjekura në rastin e shpërbërjes së Jugosllavisë treguan se diplomacia ndërkombëtare jo vetëm rezultoi e pasuksesshme në përpjekjen e saj për të prodhuar konsensus midis palëve në konflikt, por siç edhe do të përpiqem të tregoj në këtë shkrim, ajo pati një ndikim të ndjeshëm, ndonëse jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, në përshkallëzimin e konfliktit midis serbëve dhe shqiptarëve. Përpara fillimit të luftës, tre janë momentet kryesore që venë në dukje pasojat e ndërhyrjes së diplomacisë ndërkombëtare në rastin e Kosovës: 1) Konferenca mbi Jugosllavinë<sup>3</sup> dhe Komisioni Badinter<sup>4</sup>, i cili negocioi

<sup>1</sup> Kosova shpalli Pavarësinë më 17 shkurt 2008, me vendim të Parlamentit të Kosovës.

<sup>2</sup> *Uti possidetis* është një parim i së drejtës ndërkombëtare i përdorur gjerësisht gjatë procesit të dekolonializmit, sipas të cilit në fund të një konflikti territori dhe prona të tjera mbeten në kufijtë e poseduesit të mëpërparshëm. Në rastin e Jugosllavisë zbatimi i këtij parimi nënkuptonte ruajtjen e kufijve të Republikave në momentin e shpërbërjes së Jugosllavisë duke mos marrë parasysh përbërjen etnike të tyre.

<sup>3</sup> Konferenca e parë për Jugosllavinë u mbajt më 26-27 gusht 1991. Ajo u iniciua nga Britania e Madhe që mbante presidencën e Komunitetit Europian, përkatësisht Bashkimit Europian pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Maastricht, më 1 Nëntor 1993. Ajo u kryesua nga Lordi Carrington dhe kishte për qëllim propozimin



shpërbërjen e Jugosllavisë; 2) Marrëveshja në Dayton [Dejton]<sup>5</sup> që i dha fund luftës së Bosnjës; 3) Bisedimet në Rambouillet [Rambuje] midis serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës me ndërmjetësinë e diplomacisë ndërkombëtare për gjetjen e një zgjidhjeje për statusin e Kosovës. Për qëllimet e këtij artikulli, në analizën që vijon do të ndiqet linja kronologjike, e cila do të diskutohet në këndvështrimin e kuadrit normativ ekzistues që kushtëzon diplomacinë ndërkombëtare, për të vijuar me shpjegimin e efekteve të këtyre sjelljeve në rastin e konfliktit të Kosovës të shprehura në reagimin e palëve në konflikt. Këto momente, supozohet të jenë të rëndësishme në paraqitjen e një tabloje më të gjerë të konfliktit në Kosovë dhe ndihmojnë në kuptimin e zhvillimit të tij në kohë dhe problemeve të krijuara me ndikim edhe në zgjidhjen e tij.

### Rendi ndërkombëtar: Sovraniteti dhe vetëvendosja

Respektimi i parimit të sovranitetit për të cilin shtetet ndajnë një mirëkuptim intersubjektiv dhe mbi të cilin kanë zhvilluar norma, rregulla dhe institucione të përbashkëta ka treguar se i shërben mbajtjes së rregullit dhe menaxhimit të marrëdhënieve në shoqërinë e shteteve<sup>6</sup>. Tashmë që shoqëria e shteteve është shtrirë në të gjithë botën<sup>7</sup>, respektimi

e zgjidhjeve për konfliktin që kishte filluar midis Republikave Jugosllave. Për të përmbushur këtë qëllim u krijua edhe Komisioni Arbitrazhi.

<sup>4</sup> Komisioni i Arbitrazhit i Konferencës mbi Jugosllavinë, i njohur ndryshe si Komisioni Badinter, u krijua nga Këshilli i Ministrave të Komunitetit Europian më 27 gusht 1991 për t'i dhënë Konferencës mbi Jugosllavinë autoritet ligjor. Robert Badinter, një jurist i të drejtës penale dhe profesor universiteti në Francë, ish Ministër i Drejtësisë dhe Kryetar i Gjykatës Kushtetuese franceze gjatë presidencës së François Mitterrand, u emërua si Kryetari i Komisionit. Komisioni dha pesëmbëdhjetë mendime mbi "çështjet kryesore ligjore" të ngritura nga konflikti mes republikave të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

<sup>5</sup> Në tetor 1995 presidentët e Serbisë, Bosnjës dhe Kroacisë pranuan të mblidhen në bazën ajrore të Wright-Patterson, Ohio të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të diskutuar dhënien fund të dhunës në Bosnjë-Hercegovinë. Marrëveshja u arrit më 21 nëntor 1995, dhe u nënshkrua zyrtarisht në Paris më 14 dhjetor 1995. Kjo marrëveshje, që ndryshe njihet si Marrëveshja Dayton, u dha fund tre vjet e gjysmë luftë në Bosnjë.

<sup>6</sup> Hedley Bull, *An Anarchical Society. A Study of Order in World Politics*, London: Macmillan Press, 1977.

<sup>7</sup> Hedley Bull and Adam Watson, *The Expansion of International Society*. Oxford: Clarendon Press, 1984, f. 6.

i sovranitetit si princip bazë i organizimit të saj shpjegon ekzistencën e një niveli çuditërisht të lartë të rregullit dhe niveli të ulët të dhunës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Një rregull i tillë buron nga parimi i reciprocitetit që i shtyn shtetet të respektojnë sovranitetin e njëri-tjetrit pavarësisht rëndësisë dhe madhësisë së tyre në sistemin ndërkombëtar. Zhvillimi i shoqërisë së shteteve konsiderohet një hap përpara në krahasim me sistemin ndërkombëtar ku, në kushtet e anarkisë, marrëdhëniet midis shteteve përcaktohen në funksion të fuqisë dhe parimit të secilit për vete. Në shoqërinë e shteteve mbizotëron mirëkuptimi reciprok që mbështetet në një princip të vetëm, sovranitetin territorial të shtetit ku bazohen të gjitha institucionet e përbashkëta që ruajnë mirëkuptimin, nxisin bashkëpunimin dhe limitojnë konfliktin mes tyre.

Në këtë kuadër, lufta konsiderohet të jetë një institucion i veçantë dhe i pranishëm në rendin ndërkombëtar, një praktikë ndërshtetërore që "vetë shoqëria ndërkombëtare ndjen nevojën ta shfrytëzoj për të arritur qëllimet e saj"<sup>8</sup>. Në këtë konsideratë për luftën ka një pranim të dyfishtë. Duke ndjekur logjikën e rregullit në shoqërinë e shteteve *jo çdo lloj dhune konsiderohet luftë*. Brenda shoqërisë ndërkombëtare në thelb të të cilit qëndron shteti modern vetëm lufta midis shteteve sovrane (luftë ndërshtetërore) njihet si veprimtari e qëllimë me funksione të përcaktuara ndër të cilat Bull do të vlerësonte "zbatimin e ligjit ndërkombëtar, ruajtjen e balancës së fuqisë, dhe ndoshta, nxitjen e ndryshimeve në ligj, që përgjithësisht konsiderohen të drejta"<sup>9</sup>. Në këtë mënyrë në shoqërinë e shteteve *përdorimi i forcës kufizohet më shumë sesa ndalohet* dhe nuk lihet shumë hapësirë për kuptimin dhe akomodimin e luftërave të llojeve të tjera si konflikti brenda-shtetit ku futen edhe konfliktet për shpërbërjen e Jugosllavisë, pavarësinë e Timorit Lindor, etj.

Për më tepër, shoqëria e shteteve përpiqet ta rregullojë aktivitetin e luftës duke përpunuar dhe një sërë parimesh e normash të tjera me qëllim menaxhimit e saj, ku mund të vëmë në dukje: legjitimitimin apo njohjen e palëve ndërluftuese; kufizimin e tejkalimit të qëllimit të luftës nëpërmjet marrëveshjeve mbi kuadrin e veprimit ushtarak; vendosjen e pengesave ndaj zhvillimit të luftës e dëmtimit të vendeve të treta si dhe duke

<sup>8</sup> H. Bull, *An Anarchical ...*, f.188.

<sup>9</sup> *Po aty*.



kufizuar "arsyet ose duke saktësuar shkaqet për të cilat një shteti i përlligjet përdorimi i luftës" si mjet për arritjen e qëllimeve të tija kombëtare<sup>10</sup>. Me këtë kuadër normativ, i cili për hir të së vërtetës duhet thënë se nuk është tepër dinamik, është e vështirë të gjesh një status të pranueshëm ndërkombëtarisht për palët ndërluftuese në rastin e konfliktit për vetëvendosje. Në shumicën e rasteve palët në konflikt në mënyrë simpliste cilësohen si grupe terroriste, rebele, irredentiste duke vështirësuar jo vetëm kuptimin e konfliktit, por dhe cilësimin e marrëveshjeve që mund të nënshkruhen në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe që do të bënin kuptim në shoqërinë e shteteve. Mungesa e një kuadri të përshtatshëm normativ për trajtimin e vetëvendosjes dëshmon paaftësinë e shoqërisë së shteteve jo vetëm për kuptimin e këtij konflikti, por edhe pamundësinë e saj për parandalimin e përhapjes apo zgjidhjen e tij. Në rastin e konflikteve që u zhvilluan në hapësirën e ish-Jugosllavisë dhe që shënuan shpërbërjen e saj gjejmë të shprehura në momente dhe kontekste të ndryshme implikimet e sa u tha më sipër.

Në përballje me realitetin e konfliktit për vetëvendosje, kuadri normativ tradicional i shoqërisë së shteteve është kufizues<sup>11</sup>. Kërkesa e aktorëve jo-shtetërorë, të cilët kërkojnë njohjen dhe vetëvendosjen mbi të njëjtat baza sikurse edhe shtetet, konsiderohet si e papërligjur për sa kohë që aktorët jo-shtetërorë nuk gëzojnë njohjen si shtet sovran. Në praktikën ndërkombëtare bashkëkohore, njohja e të drejtës së vetëvendosjes për aktorët jo-shtetërorë ende mbetet një akt politik<sup>12</sup>, një akt që përndryshe përfaqëson "një masë të konsiderueshme përshtatje funksionale"<sup>13</sup> që frymëzohet më së pari nga respektimi i sovranitetit territorial dhe që në të njëjtën kohë përlligj refuzimin e shteteve për ndryshimin e kufijve ekzistues. Për rrjedhojë, marrëveshja e ofruar ndaj kërkesës së palëve ndërluftuese për vetëvendosje përfaqëson konsensusin politik midis shteteve, i cili frymëzohet më së pari nga respektimi i sovranitetit

<sup>10</sup> *Po aty*.

<sup>11</sup> Graham Evans and Jeffrey Newnham, *Penguin Dictionary of International Relations*, London: Penguin Books, 1998, f. 97.

<sup>12</sup> Inis L. Jr Claude, "Collective Legitimization as a Political Function of the United States", *International Organization* 20 (3), September 1966, f. 367-379.

<sup>13</sup> Barry Buzan, "From International System to International Society: Structural Realism and Regime Theory Meet the English School", *International Organization* 47 (3), Summer 1993, f. 334.

territorial dhe që në të njëjtën kohë përlligj refuzimin e shteteve për të pranuar ndryshime në këtë kuadër.

Në argumentimin e mësipërm, vlerësohet vështirësia e shoqërisë ndërkombëtare në trajtimin e konfliktit brenda-shtetëror, i cili konsiderohet si sfidues për konceptin e sovranitetit dhe për qendrueshmërinë e rendit ndërkombëtar. Këto vështirësi manifestohen në politikat dhe në qëndrimet kontradiktore të komunitetit ndërkombëtar ndaj rasteve të ndryshme në praktikë të këtij konflikti.

Çdo sfidë ndaj parimit të sovranitetit konsiderohet shqetësues për rendin e sotëm ndërkombëtar. Ndaj njohja e të drejtës së vetëvendosjes nëpërmjet luftës mbetet ende problematike në gjykimin e shoqërisë së shteteve për shkak të mungesës së një kuadri të përshtatshëm normativ për trajtimin e problematikave që lidhen me të. Në shpërbërjen e ish-Jugosllavisë gjejmë pikërisht të shprehur ndikimin e mungesës së një kuadri të tillë normativ për trajtimin e çështjes së vetëvendosjes, të manifestuar edhe në politikat dhe në qëndrimet kontradiktore të diplomacisë ndërkombëtare ndaj këtij konflikti. Këto politika dhe zgjidhjet e ofruara deri në momentin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës të motivuara nga nevoja për ruajtjen e sovranitetit dhe rendit ndërkombëtar, patën një ndikim kontradiktor mbi palët në konflikt, dhe si rrjedhojë edhe mbi zhvillimin e konfliktit. Nëse do t'i referoheshim Jan Oberg, diplomacia ndërkombëtare "ka qenë një pjesë përbërëse e konfliktit, jo një ndërmjetës i paanshëm"<sup>14</sup>, dhe si e tillë duhet të pranojë një pjesë të përgjegjësisë për shpërthimin e luftës. Diplomacia ndërkombëtare në përgjithësi dhe Bashkimi Europian në veçanti, i cili mori rolin kryesor në zgjidhjen e aspektit normativ të shpërbërjes së Jugosllavisë, dështuan në zgjidhjen e shumë çështjeve, të cilat më pas iu shtuan shkaqeve të konflikteve në Bosnje, Kosovë dhe Maqedoni. Pikësynimi i këtij artikulli është pikërisht të pasqyrojë implikimet e politikave të ndjekura dhe zgjidhjet e propozuara nga diplomacia ndërkombëtare në shpërbërjen e Jugosllavisë, duke vënë theksin në rastin e Kosovës. Kështu, në vijim do të përpiqem të argumentoj se ndërhyrjet e diplomacisë ndërkombëtare i shtuan tensionet ekzistuese midis shtetit serb dhe shqiptarëve të Kosovës, deri në shpërthimin e një katastrofe

<sup>14</sup> Jan Oberg, "TFF on CNN – 3<sup>rd</sup> time on Kosovo", *Pressinfo*, 27 Janar 2000, marrë në site: electronic version at: <http://www.transnational.org/pressinf/2000/pf84.html>, fq. 84.



humanitare. Zhvillimet në terren e detyruan diplomacinë ndërkombëtare të ri-konsideronte ndërhyrjet jashtë skemës normative tradicionale që synojnë ruajtjen e sovranitetit.

### Shpërbërja: Konferenca e Paqes dhe Komisioni Badinter (1991-1995)

Konferenca e Paqes mbi Jugosllavinë, organizuar në gusht të vitit 1991 themeloi Misionin e Komunitetit Europian të Monitorimit dhe Komisionin e Arbitrazhit, i njohur ndryshe si Komisioni Badinter, me autoritet për të negociuar zgjidhjet e mundshme në kuadrin e shpërbërjes së Jugosllavisë. Konferenca u ofrua si forum për diskutimin e një kompromisi midis Republikave që kërkonin mëvetësinë nga Federata Jugosllave. Në të njëjtën kohë, ajo propozoi një kuadër veprimi të bazuar mbi disa praktika ndërkombëtare, të cilat ishin zbatuar më parë në raste të ngjashme të de-kolonializimit në Afrikë e tjetërkund në vitet 1960-1970. Çështjet kryesore, me të cilat u mor Komisioni, siç edhe përkufizohet nga Alain Pellet<sup>15</sup>, ishin përcaktimi "i qëllimit të parimit të vetëvendosjes siç ishte tashmë zbatuar në kontekste të veçanta, veçanërisht në kuadrin e dekolonializimit; raporti i këtij parimi me një tjetër parim po aq të rëndësishëm e themelor siç është parimi i qëndrueshmërisë së kufijve; dhe së fundi roli që mund të luajë një organ ndërkombëtar arbitrimi në raste të tilla".<sup>16</sup>

Në rastin e shpërbërjes së Jugosllavisë çështja e vetëvendosjes u trajtua në funksion të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ashtu si parashkruhet në konventat ndërkombëtare<sup>17</sup>, të cilat duhet të garantoheshin pa vënë në dyshim sovranitetin territorial të shtetit. Kështu, u formuluan "norma urdhëruese" që kërkonin respektimin e vlerave njerëzore e

<sup>15</sup> Ekspert francez i të drejtës ndërkombëtare, anëtar dhe ish-president i Komisionit të Ligjit Ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara dhe këshilltar i qeverive të vendeve të ndryshme, duke përfshirë edhe qeverinë franceze, në fushën e së drejtës publike ndërkombëtare. Ai ka qenë gjithashtu ekspert pranë Komisionit të Arbitrazhit Badinter si dhe raportues i Komitetit të Juristëve francezë për krijimin e një Gjykate Penale Ndërkombëtare për krimet e luftës në ish-Jugosllavi ("Komisioni TRUCHE").

<sup>16</sup> Alain Pellet, "The Opinions of the Badinter Arbitration Committee. A second Breath for the Self-Determination of Peoples", *European Journal of International Law* 3, 1992, f. 179.

<sup>17</sup> Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut, 1966.

demokratike nga Republikat që kërkonin njohje ndërkombëtare. Një qasje e tillë synonte, siç edhe thuhet shprehimisht në Deklaratën e Komunitetit Europian mbi Jugosllavinë, datë 3 shtator 1991, miratuar nga Konferenca Europiane e Paqes në Takimin e Jashtëzakonshëm Ministror në Hagë, të "siguronte një përmbushje paqësore të aspiratave konfliktuale të popujve jugosllavë".<sup>18</sup> Frymëzuar nga rekomandimet e Komisionit Badinter, diplomacia ndërkombëtare u tregua e kujdesshme të siguronte një balancë të pranueshme, nga njëra anë midis sovranitetit territorial dhe pavarësisë së shteteve, dhe nga ana tjetër midis realitetit të një bote të ndërvarur dhe përkushtimit të së drejtës ndërkombëtare ndaj respektimit të dinjitetit njerëzor. Të dy dokumentet kryesore të dala nga Konferenca, *Deklarata* dhe *Udhëzuesi për Njohjen Ndërkombëtare*, e kufizuan parimin e vetëvendosjes duke vendosur rregulla që favorizonin vetëm Republikat si shtete pasuese të Jugosllavisë, duke lënë jashtë këtij diskutimi problemin e kombësive dhe grupeve të veçanta etnike. Sipas studiuesit kosovar, Enver Hasani "vetëvendosja jugosllave, që atëherë ka mbetur e pandryshuar dhe ka ndjekur premisat bazë të parashikuara nga këto dy dokumente".<sup>19</sup>

Kështu, në rastin e Kosovës, shqiptarët mund të synonin të realizonin njohjen e kombësisë së tyre, sikundër edhe të drejtat e tyre qytetare dhe politike brenda shtetit serb, që ndryshe u quajt vetëvendosje e brendshme. Kjo zgjidhje u ofrua për të gjithë grupet etnike brenda Republikave të Federatës Jugosllave. Të drejtat e shqiptarëve në Kosovë si dhe të grupeve të tjera etnike, serbëve në Krajinë (Kroaci) dhe hungarezëve në Vojvodinë (Serbi), do të mund të mbroheshin nëpërmjet mekanizmave kushtetues të negociuara në nivel ndërkombëtar. Në funksion të një zgjidhjeje të tillë, njohja e sovranitetit të Republikave të Jugosllavisë si shtete më vete u kushtëzua paraprakisht nëpërmjet kërkesës që "Republikat duhet t'u garantojnë anëtarëve të pakicave dhe grupeve etnike, të gjitha të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të njohura nga ligji ndërkombëtar, duke përfshirë, kur shihej e përshtatshme, të

<sup>18</sup> "EC Declaration on Yugoslavia" (3 September 1991), Adopted at the European Peace Conference Extraordinary Ministerial Meeting, Cituar nga Snezana Trifunovska ed., *Yugoslavia Through Documents*, Hagë: Martinus Nijhoff Publishers, 1994.

<sup>19</sup> Enver Hasani, *Self-Determination, Territorial Integrity and International Stability. The case of Yugoslavia*, Bilkent, Ankara: Bilkent University Library (Ph.D. Dissertation), 2001, f. 205.



drejtën e kombësisë së tyre”.<sup>20</sup> Këto vlera me kërkesë të diplomacisë ndërkombëtare që po merrej me çështjen e shpërbërjes së Jugosllavisë, u sanksionuan në kushtetutat e të gjitha shteteve të reja pasuese të Federatës Jugosllave. Për më tepër, kjo lloj politike përfaqëson një tendencë të përgjithshme të politikave të vendeve perëndimore ndaj rasteve të ngjashme që do të pasonin në të ardhmen.<sup>21</sup>

Risia e Komisionit Badinter qëndron në kombinimin e parimit të sovranitetit territorial me respektimin dhe institucionalizimin e vlerave demokratike dhe të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve në trajtimin e çështjes së vetëvendosjes. Pas kësaj përpjekje të kombinuar normative dhe emancipuese të diplomacisë ndërkombëtare, qëndron sfida e mungesës së një autoriteti mbi-shtetëror detyruës në arenën ndërkombëtare që të kontrollojë dhe imponojë me çdo kusht respektimin e këtyre të drejtave brenda shtetit. Në praktikë, njohja *de jure* e Republikave të reja u shoqërua me konflikte të përgjakshme ndonëse kushtetutat e tyre angazhoheshin për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve dhe pakicave kombëtare. Në përgjigje të zhvillimeve të tilla, diplomacia ndërkombëtare u detyrua të ndërmerre masa të tjera shtrënguese për të siguruar zbatimin e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve. Kështu, mund të përmendim misionet paqeruajtëse, sanksionet, mosnjohjen ndërkombëtare deri dhe ndërhyrjet ushtarake, të cilat u përdorën në rastin e Bosnje-Hercegovinës dhe Kosovës si domosdoshmëri për të ndaluar dhunimin në përmasa të egzagjeruara deri në gjenocid të grupeve të ndryshme etnike brenda Republikave të ish-Federatës Jugosllave.

Mbas përcaktimit të parimeve mbi bazën e të cilave do të bëhej njohja ndërkombëtare e njësive të cilat do të gëzonin sovranitet në kuadrin e Federatës Jugosllave në shpërbërje, Komisioni Badinter i kushtoi vëmendje mënyrës së përcaktimit të kufijve. U legjitimua parimi *uti possidetis juris* (respektim i kufijve ekzistues në momentin e pavarësisë), i cili bazohej sikundër vë në dukje Pellet “në shkëputjen e

<sup>20</sup> A. Pellet, “The Opinions ...”, f. 184.

<sup>21</sup> Menno T. Kamminaga, “State Succession in Respect of Human Rights Treaties”, *European Journal of International Law* 7(4), 1996, f. 469-485; Vladlen S. Vereshchetin, “New Constitutions and the Old Problem of the Relationship Between International and National Law”, *European Journal of International Law* 7(1), 1996, f. 29-42.

konceptit të kombësisë prej atij të territorit”.<sup>22</sup> Kështu, si kufij të Republikave u ruajtën ato që ekzistonin në kuadrin e Federatës. Kjo praktikë e bazuar në epërsinë e parimit të integritetit territorial apo ndryshe të mos ndryshimit të kufijve, e cila u konsiderua qenësore për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Europë duke mbetur kështu në kuadrin e Marrëveshjes së Helsinkit (1975) dhe Kartës së Parisit (1990). Kërkesa e shqiptarëve të Kosovës për trajtimin e çështjes së tyre në të njëjtën mënyrë si edhe në rastin e Republikave të Federatës Jugosllave, u refuzua pikërisht në bazë të këtij parimi.

Në dokumentin “Letra e Qeverisë së Republikës së Kosovës drejtuar Mbledhjes së Jashtëzakonshme Ministrore të Komitetit Politik European (EPC) në Bruksel, 21 dhjetor 1991”<sup>23</sup>, udhëheqja e shqiptarëve të Kosovës argumentoi se, brenda kuadrin të Kushtetutës së vitit 1974, Kosova gëzonte të drejta të barabarta përfaqësimi në nivelin federal me Republikat e tjera, ndonëse kishte statusin e një Krahine Autonome. Duke u bazuar mbi këtë argument u kërkua që Kosova të konsiderohej ashtu si Republikat e tjera, një njësi përbërëse e Federatës Jugosllave. Me gjithë kërkesën e udhëheqjes së shqiptarëve, Komisioni Badinter vendosi të mos pajisë me sovranitet Kosovën, pasi raste të tilla të ngjashme nuk u negociuan në kuadrin e shpërbërjes së Jugosllavisë as në rastin e Republikave të tjera.

Çështja e Kosovës mbeti nën kujdestarinë e Republikës së Serbisë, e cila duhej të kujdesej për interesat e shtetit dhe të sigurisë të të gjithë shtetasve të saj, në pajtim me detyrimet ndërkombëtare të respektimit të të drejtave të njeriut dhe pakicave kombëtare. Një zgjidhje e tillë i mohoi Kosovës të drejtën e vetëvendosjes. Vendosija e kushtit për përfshirjen në Kushtetutën e Republikës së Serbisë të neneve mbi respektimin e të drejtave të njeriut dhe pakicave kombëtare u konsiderua si *modus vivendi* për zgjidhjen e rastit të Kosovës, duke “shpëtuar” diplomacinë ndërkombëtare nga trajtimi i çështjes së vetëvendosjes për kombësitë e ndryshme në brendësi të Republikave të ndryshme të Federatës Jugosllave. Kështu, Komisioni Badinter zbatoi formalisht në një kontekst të ri dispozitat e ligjit ndërkombëtar për dekolonializimin.

<sup>22</sup> A. Pellet, “The Opinions ...”, f. 180.

<sup>23</sup> *E vërteta mbi Kosovën*, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Shtëpia e Botimeve Enciklopedike, 1993.



Zgjidhja formale e propozuar nga Komisioni për rregullimin e marrëdhënieve midis serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës në kuadrin e Republikës së Serbisë nuk mbante parasysh realitetin e këtyre raporteve që ishin përkeqësuar që përpara se të fillonte shpërbërja e dhunshme e Jugosllavisë dhe që tashmë i kishte tejkaluar dispozitat e parimeve që qëndronin në bazë të zgjidhjes së propozuar. Kështu, në realitet ishte tejkaluar zgjidhja paqësore nëpërmjet parimeve demokratike të problemit të Kosovës banuar kryesisht nga shqiptarët.

Prej kohësh përgjigjja e regjimit të Milosheviçit ndaj të drejtave të shqiptarëve në Kosovë ishte dhuna dhe represioni i vazhdueshëm që përvijoi me heqjen e autonomisë së fituar me Kushtetutën Jugosllave të vitit 1974. Këto politika kishin sjellë për pasojë përshkallëzimin e reagimeve të popullsisë shqiptare të Kosovës në mbrojtje të autonomisë.<sup>24</sup> Në 600-vjetorin e Betejës së Kosovës, Milosheviçi do t'u premtojte serbëve të Kosovës se "askush nuk do t'i keqtrajtojte ata" dhe kjo shënoi dhe fillimin e serbizimit të Kosovës dhe në të njëjtën kohë fillimin e një periudhe tepër të rëndë për shqiptarët të cilët jo vetëm po trajtoheshin si qytetarë të rendit të dytë, por edhe po u nënshtroheshin torturave sistematike nga regjimi serb.<sup>25</sup> Në një situatë të tillë më 2 korrik 1990 Kuvendi i Kosovës shpall Kosovën nëpërmjet Deklaratës Kushtetuese "njësi të pavarur dhe të barabartë brenda kuadrin të Federatës së Jugosllavisë, dhe si një subjekt të barabartë përkundrejt palëve të tjera në Jugosllavi".<sup>26</sup> Dy muaj pas shpalljes së Deklaratës Kushtetuese më 7 shtator 1990, të njëjtët delegatë nxorën aktin më të lartë juridik - Kushtetutën e Republikës së Kosovës e cila edhe formalisht e shpallte Kosovën Republikë. Në shtator 1991, një referendum i fshehtë mbarëpopullor në Kosovë miratoi pavarësinë me "po"-në e 87,01% të votuesve të popullsisë së Kosovës.<sup>27</sup> Të gjitha këto akte kushtetuese nuk u përligjën

<sup>24</sup> H. Clark, *Civil Resistance ...*

<sup>25</sup> Zlatko Isakovic, "Diplomacy and the Conflict in Kosovo - Notes on Threats and Fears", *International Studies Association*, Washington: February 1999, f. 1.

<sup>26</sup> Deklarata Kushtetuese e Asamblesë së Kosovës (1990), *E vërteta mbi Kosovën*, f. 329.

<sup>27</sup> Stefan Troebst, "Conflict in Kosovo: Failure of Prevention? An Analytical Documentation, 1992-1998", *ECMI Working Paper Nr.1*, Flensburg, Germany (1998); Laura Silber, "Defiant Serbian Province Votes on Independenc",

nga Komisioni Badinter. Me vendimet e tij, Komisioni Badinter nuk mori parasysh jo vetëm pavarësinë e vetëdeklaruar dhe kërkesat e udhëheqjes së shqiptarëve të Kosovës për t'u konsideruar si një entitet i barabartë me Republikat e tjera të Jugosllavisë, por edhe situatën e rënduar konfliktuale në terren që tashmë i kishte tejkaluar parimet e propozimeve të tij.

Dispozitat e *Udhëzuesit* apo *Dokumentit të Njohjes* të Komisionit Badinter u zbatuan në mënyrë arbitrare pa u negociuar me të gjitha palët e interesuara në Jugosllavi. Marrëveshja u imponua nga bashkësia ndërkombëtare, pasi moscenimi i kufijve u konsiderua si kusht paraprak për ruajtjen e stabilitetit rajonal dhe ndërkombëtar. Ky vendim vetëm sa e ngriu situatën për pak kohë duke mos e lënë që të përshkallëzohej në formën e një konflikti ndërkombëtar, ndërkohë që polarizoi qëndrimet e palëve në konflikt dhe radikalizoi kërkesat e tyre. Për disa studiues, vendimet e Komisionit Badinter shihen si një ndër shkaqet e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe tragjedive që pasuan.<sup>28</sup> Nga fundi i vitit 1991, Konferenca dështoi të parandalonte luftën, pasi i ishte përkushtuar vetëm mekanizmave paqeruajtëse për të zëvendësuar ndërhyrjet ushtarake.<sup>29</sup> Kështu, shumë pak u bë nga diplomacia ndërkombëtare për të ndaluar "serbët të angazhoheshin në spastrime etnike për të krijuar territore të qeverisura nga serbët, të cilat ata shpresonin se do t'i bashkëngjiteshin vetë Serbisë".<sup>30</sup> Duke bërë paralelizma midis politikave serbe të spastrimit etnik në Bosnje e Kroaci ku ndërhyrja e komunitetit ndërkombëtar nuk përbënte një opsion në fillim të viteve 1990, serbëve iu përçua heshtazi mesazhi se në Kosovë nuk do të kishte ndërhyrje

*Washington Post*, 25 May 1992, f. 20; Peter Maass, "Serbians Pressing Ethnic Albanians in Uneasy Kosovo", *Washington Post*, 15 July 1991, f. 13.

<sup>28</sup> Thomas Raju, "Nations, States and Secession: Lessons from the Former Yugoslavia", *Mediterranean Quarterly* 5 (4), (Fall 1994), f. 40-65; Peter Radan, "The Badinter Arbitration Commission and the Partition of Yugoslavia", *Nationalities Papers* 25, 1997, f. 537-557.

<sup>29</sup> Mats R. Berdal, "Whither the UN Peacekeeping?", *Adelphy Paper* 281, London: International Institute for Strategic Studies, 1993; Shashi Tharoor, "United Nations and Peacekeeping in Europe", *Survival* 37, Summer 1995, f.121-134; Bertrand de Rossanet, *Peacemaking and Peacekeeping in Yugoslavia*, The Hague: Kluwer Law International (1996).

<sup>30</sup> Wallace J. Thies, "Compellence Failure or Coercive Success? The Case of NATO and Yugoslavia", *Comparative Strategy* 22, 2003, f. 246.



ushtarake ndaj ata mund të vazhdonin të pashqetësuar politikat e tyre ekspansioniste.<sup>31</sup>

Kuadri ekzistues normativ ndërkombëtar rregullon marrëdhëniet midis shteteve dhe si i tillë mbart kufizime kur flitet për trajtimin e problematikave brenda shtetit, ndaj vendimet e diplomacisë ndërkombëtare nuk dolën përtej të drejtës ndërkombëtare tradicionale për sa i përket trajtimit të problemeve që rridhnin nga shpërbërja e Jugosllavisë. Si rrjedhim, vendimet e Konferencës ishin të dykuptimta dhe jo përfundimtare, si të tilla ato i jepnin dorë të lirë aktorëve lokalë të gjenin mënyrën për të realizuar pritshmëritë dhe zgjidhjet e tyre të preferuara. Në shumicën e rasteve, dhuna u zgjodh nga aktorët lokalë si mjete për të realizuar qëllimet e tyre të parapërcaktuara të krijimit të shteteve të tyre etnike të spastruara nga grupet e tjera etnike. Megjithatë, nga ky përgjithësim, duhet të përjashtohet rasti i Kosovës dhe Maqedonisë, që në fillim të shpërbërjes së Federatës dukeshin në kërkim të zgjidhjeve me mjete paqësore.

Për rastin e Kosovës, që nuk ishte pjesë në marrëveshjen kryesore të shpërbërjes së Jugosllavisë, *Udhëzuesi mbi Njohjen* i përpiluar nga Komisioni i Arbitrazhit përçoi mesazhe kontradiktore ndaj palëve në konflikt. Beogradi e shihte rastin e Kosovës si një çështje të brendshme të shtetit serb, që në asnjë mënyrë nuk duhej të ndërkombëtarizohej. Konferenca nuk mori përsipër të përdorë forcën ushtarake, në rast se zgjidhjet e propozuara nuk arriheshin nëpërmjet kompromisit. Në këto rrethana, Milosheviçi e ndjeu veten të sigurt në ndjekjen e qëllimeve të tij të luftës, duke e konsideruar Konferencën si një ndërmjetës pa asnjë efekt detyrues ndaj palëve në konflikt.

Nga ana tjetër, zgjidhjet që u ofruan nga *Udhëzuesi mbi Njohjen* sugjerorin vetëvendosje të brendshme, pra vetëqeverisje dhe autonomi të zgjeruar brenda Republikës serbe, për shqiptarët e Kosovës. Ky vendim sfidonte ruajtjen e *status quo-së*.<sup>32</sup> Nga njëra anë, vendimi i ndërmarrë

<sup>31</sup> Daniel Binder, "Bush Warns Serbs Not to Widen the War", *New York Times*, 28 December 1992, f. 6; John Goshko, "Bush Threatens "Military Force" if Serbs Attack Kosovo Province", *Washington Post*, 1992, f. 10.

<sup>32</sup> Håkan Wiberg, "Identifying Conflicts and Solutions", *Romanian Journal of International Affairs*, Vol. 4, No. 1, 1998; Jan Oberg, "Conflict Mitigation in Former Yugoslavia-It Could Be Still Possible", in Radmila Nakarada ed. *Europe and Disintegration of Yugoslavia*, Beograd: Instituti i Studimeve Europiane (1998); S. Troebst, "Conflict in Kosovo ...".

nga Milosheviçi për heqjen e statusit të autonomisë së Kosovës dhe Vojvodinës, e bënë Serbinë një Republikë të centralizuar brenda strukturës së Federatës Jugosllave, dhe si e tillë mundësia për vetëqeverisje të kombësive të tjera brenda Serbisë ishte bërë e pamundur. Kështu, me vendimin e Komisionit Badinter, pavarësia e Kosovës si njësi e mëvetësishme nuk përlligjej. Nga ana tjetër, Serbia, si një Republikë e njohur nga vendimet e Komisionit Badinter, kufizohej në ushtrimin e plotë të të drejtave të saj sovraane si një Republikë e centralizuar, që nga momenti që dy krahinat, Kosova dhe Vojvodina, gëzonin sipas të njëjtave dispozita të drejtën e vetëvendosjes së brendshme brenda Republikës së Serbisë. Këto paqartësi në dokumentin e *Udhëzuesit mbi Njohjen* promovuan pasiguri, meqenëse asnjëra nga palët në fjalë nuk ishte e qartë për statusin e vet, brenda Serbisë, e cila ishte njohur si pjesë përbërëse e Federatës Jugosllave me të drejtë shkëputjen prej saj.

Vendimet e Komisionit, ndonëse jo në mënyrë të qëllimshme, forconin pozitën e serbëve të cilët ishin tashmë përgjegjës të vetëm për respektimin e vetëqeverisjes së brendshme të grupeve etnike madje dhe njohjes së kombësisë së tyre brenda Republikës Serbe që pak gjasa kishin që të viheshin në jetë nga regjimi i Milosheviçit. Ndaj në momentin që vendimet e Komisionit Badinter u bënë të qarta, një "rezistencë civile"<sup>33</sup> e organizuar dhe jo e dhunshme filloi nga shqiptarët e Kosovës në mbrojtje të së drejtës së tyre për vetëvendosje jashtë kuadrit të Serbisë. Kjo u shoqërua me përshkallëzimin e ushtrimit të dhunës dhe shtypjes ndaj shqiptarëve të Kosovës.<sup>34</sup> Studiues të ndryshëm vlerësojnë se "uria e planifikuar"<sup>35</sup> ndaj shqiptarëve u zgjodh nga regjimi i Beogradit si një mjet për të zgjidhur "problemet" që po shqetësonin Serbinë që në fillim të viteve 1990. Në thelb të këtyre politikave ishte përjashtimi i shqiptarëve nga gjithë aktiviteti ekonomik, publik, politik e kulturor në Kosovë. Në kushtet e mungesës së punësimit, shërbimit shëndetësor, arsimimit e informimit në gjuhën amtare e jetës kulturore pritej që të

<sup>33</sup> H. Clark, *Civil Resistance ...*

<sup>34</sup> Paula Tscherne-Lempiainen, *From Autonomy to Colonization: Human Rights in Kosovo 1989-1993*, Vienna: IHF, November 1993; Ivana Nizich *Yugoslavia: Human Rights Abuses in Kosovo 1990-1992*, New York: Human Rights Watch, 1992.

<sup>35</sup> Christine von Kohl and Wolfgang Libal, *Kosovo: Gordischer des Balkan*, Wien/Zürich: Europaverlag, 1992; Fabian Schmidt, "Kosovo: The Time Bomb That Has not Gone Off," *RFE/RL Research Report*, 2 (39), 1 October 1993, f. 21-29.



vihej në rrezik vetë mbijetesa e shqiptarëve në Kosovë, ndaj dhe me të drejtë u quajtën politikat e “urisë së planifikuar”. Studiuesi kroat, Cvijeto Job, shpjegon filozofinë e këtyre politikave nëpërmjet përvijimit të pyetjes që serbët i bënin vetes në atë kohë: “Pse duhet ne të jemi një minoritet në shtetin tonë, kur ju (të tjerët) mund të jeni një minoritet brenda shtetit tonë?”. Me qëllim realizimin e një plani të tillë politikat e “urisë së planifikuar” filluan të merrnin jetë që pas një farë kohe të krijonin situatën e “asnjë minoriteti në shtetin tim etnikisht homogjen”.<sup>36</sup> Këto politika u favorizuan nga fakti që problematika e Kosovës konsiderohej si një çështje e brendshme e Serbisë. Një çështje, të cilën si autoritetet qeverisëse të Serbisë ashtu edhe opozita serbe, të bashkuar në një front për çështjen e Kosovës, jo vetëm nuk donin ta ndërkombehtarizonin, por edhe ndanin të njëjtin mendim e qëndrim.<sup>37</sup>

Me gjithë situatën e vështirë të krijuar për shqiptarët në Kosovë nga politikat e regjimit të Beogradit, konflikti ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe Serbisë vazhdoi edhe për një kohë të gjatë me anë të mjeteve paqësore. E vetmja mënyrë për të dalë nga situata e “urisë së planifikuar” ishte ndërtimi i një jetese paralele në Kosovë, që do të mund t’u jepte shqiptarëve mundësinë për të mbijetuar brenda Serbisë. Brenda shtetit të Serbisë u ndërtua një “shtet paralel” me parlamentin e tij, qeverinë dhe sistemin e tij financiar, arsimor dhe shëndetësor. Ky “shtet” financohej nga shqiptarë të Kosovës; emigrantë në Perëndim, të cilët paguanin 3 për qind të të ardhurave të tyre për buxhetin e “shtetit në hije”.<sup>38</sup>

Autoritetet e Beogradit toleruan shumicën e strukturave paralele të krijuara nga shqiptarët e Kosovës pasi kjo i shërbente mbajtjes së konfliktit në profil të ulët dhe në këto kushte çështja e Kosovës nuk ndërkombehtarizohej. Kështu shqiptarët e Kosovës nuk përfshiheshin në mbledhjen e taksave dhe në rekrutimet në ushtri. Sipas studiuesit të Europës Juglindore në Universitetin e Leipzig, Stefan Troebst ndikim të

<sup>36</sup> Cvijeto Job, “Yugoslavia's Ethnic Furies,” *Foreign Policy* 92, Fall 1993, f. 52-53.

<sup>37</sup> Konrad Clewing, “Die Radikale Kosovopolitik der Politischen Opposition in Serbia: Noch ein Grund für Eine Internationalisierung des Serbisch-Albanischen Dialogues”, *Sudosteuropa* 44, 1995, f. 44.

<sup>38</sup> Denisa Kostovicova, “Parallel Worlds: Response of Kosovo Albanians to Loss Autonomy in Serbia, 1986-1996”, *Keele European Research Centre Research Papers: Southeast Europe, Series 2*, Keele: Keele University, 1997.

madh në ndarjen e “shteteve” dhe shoqërisë serbe e kosovare kontribuoi shkalla e ulët e fërkimeve politike.<sup>39</sup> Mirëpo, duhet përmendur se të dyja, si veprimet tjetërsuese dhe ekspansioniste të serbëve në rajon, ashtu edhe mënyra sesi diplomacia ndërkombëtare trajtoi problemin e Kosovës, shkaktuan dëme të pariparueshme në bashkëjetesën paqësore shqiptaro-serbe. Qëndrimi injorues ndaj zhvillimeve në Kosovë provokoi një përshkallëzim të kërkesave të shqiptarëve, të cilët shtuan kërkesat e tyre, nga një zgjidhje paqësore të situatës shtypëse, në përfitimin e statusit të një entiteti të barabartë brenda strukturës së Federatës Jugosllave, e më vonë për pavarësi të plotë.

Organizimi i rezistencës paqësore ishte përgjigjja e udhëheqjes së shqiptarëve të Kosovës ndaj vendimeve të Konferencës me qëllim tërheqjen e vëmendjes së diplomacisë ndërkombëtare. Të dyja palët, si shqiptarët e Kosovës ashtu dhe serbët nuk punuan për zgjidhje të përbashkëta. Secila palë u përpoq të formësojë profilin e saj dhe të përcaktojë kufijtë e konfliktit. Në këtë tablo, mungonte vetëm lufta. Megjithatë, kjo gjendje nuk përjashtonte rrezikun e konfrontimit në të ardhmen, pasi palët e ndjenin veten të penguar për të jetuar sipas pritshmërive të tyre.

### Modeli i Paqes: Marrëveshja në Dayton (1995-1998)

Marrëveshja e Paqes midis palëve ndërluftuese në Bosnjë-Hercegovinë u arrit më 21 nëntor 1995, në bazën ajrore Wright-Patterson në Dayton, Ohio. Teksti i Marrëveshjes u nënshkrua në Paris më 14 dhjetor 1995. Marrëveshja ishte një tjetër moment i rëndësishëm në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë me ndikim në çështjen e Kosovës. Marrëveshja e Daytonit nuk e mori në konsideratë rastin e Kosovës, ndonëse Milosheviçi ishte prezent si përfaqësues i njërës prej palëve ndërmjetësuese të kompromisit të paqes. Sipas Richard Caplan, tre janë arsyt kryesore që përjashtuan shqiptarët e Kosovës nga marrëveshja me Milosheviçin. *Së pari*, diplomacia ndërkombëtare mendonte se kishte shumë për të negociuar me Milosheviçin, ndërkohë që ekzistonte një mosmarrëveshje për çështjet e bashkëpunimit dhe dorëzimit të kriminelëve të luftës të kërkuar nga Gjykata e Hagës. *Së dyti*, askush nuk donte ta tjetërsonte Milosheviçin nga të cilësuarit si paqebërës, pasi ai kishte ndërmjetësuar me serbët e Bosnjës për pranimin nga ana e tyre të

<sup>39</sup> S. Troebst, “Conflict in Kosovo ....”, f. 08.



kompromisit të paqes. Bashkëpunimi i tij konsiderohej ende i nevojshëm për vënien plotësisht në jetë të Marrëveshjes Dayton. *Së treti*, në Kosovë nuk kishte ende luftë, prandaj nuk ndihej nevoja për t'u marrë me këtë çështje.

Kosova përbënte një çështje të ndjeshmërisë së lartë për Serbinë, ndaj udhëheqja e shqiptarëve të Kosovës nuk u ftua të marrë pjesë në tryezën e negociatave. Çështja e Kosovës u përmend vetëm një herë në tekstin e Marrëveshjes Dayton në lidhje me parakushtet që duhet të plotësoheshin me qëllim heqjen e “embargos së jashtme” (outer wall of sanctions) mbi entitetin që kishte mbetur nga ish Federata Jugosllave, Serbia dhe Mali i Zi. Koncepti i “embargos së jashtme” mbi Jugosllavinë u bë i qartë në Deklaratën e Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara, më 23 nëntor 1995, dy ditë pas nënshkrimit të Marrëveshjes. Kjo Deklaratë kushtëzonte njohjen e plotë të Federatës Jugosllave dhe anëtarësimin e saj me të drejta të plota në organizata të ndryshme ndërkombëtare, kryesisht me qëndrimin e Serbisë ndaj “Kosovës dhe bashkëpunimit me Gjykatën e Krimeve të Luftës.”<sup>40</sup> Duket se ky dokument para se gjithash shprehte vetëm qëndrimin amerikan ndaj çështjes së Kosovës, pasi sanksionet tregtare ndaj Federatës Jugosllave ishin pezulluar nga Rezoluta 1022 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1995, pra vetëm 3 ditë përpara lëshimit të Deklaratës dhe një ditë përpara arritjes së Marrëveshjes Dayton. Ndërkohë, sanksionet u hoqën plotësisht nga Rezoluta 1047 më 1 tetor 1996, megjithëse çështja e Kosovës nuk kishte marrë ende ndonjë zgjidhje të qenësishme.

Ndonëse, në momentin kur u nënshkrua Marrëveshja Dayton në Kosovë nuk kishte luftë, dispozitat e dokumentit të nënshkruar me Milosheviçin krijuan efekte negative në mundësitë e zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Sipas Troebst, zgjidhjet e nënkuptuara të ofruara në Daytoni për serbët dhe shqiptarët e Kosovës, e bënë më se të dukshëm paqëndrueshmërinë e modelit unik të bashkëjetesës armiqësore.<sup>41</sup> Milosheviçi nuk u fajësua për politikën e tij të ashpër me implikime serioze ndaj të drejtave të njeriut në Kosovë. Përkundrazi, ai u vlerësua si një paqebërës dhe garantues i Marrëveshjes Dayton, e cila bëri të qartë, ashtu siç shprehet edhe ambasadori britanik në Beograd, Yvor Roberts, se

Kosova është një çështje e politikave të brendshme të Jugosllavisë. Me entuziazëm e përditshmja “Naša Borba” vlerësonte diplomacinë ndërkombëtare, e cila vazhdonte të përsëriste se nuk do të mbështeste asnjë lloj ndarje të Kosovës nga Jugosllavia.<sup>42</sup> Lidhshipi politik serb, përfshirë edhe opozitën, favorizonin ruajtjen e *status quo-së* për çështjen e Kosovës që favorizonte ruajtjen dhe forcimin e Republikës së Serbisë, si entitet unitar dhe njësi themeluese e Federatës së re Jugosllave. Edhe opozita e kryesuar nga Vuk Draškovic, President i Partisë Rilindja Serbe, kundërshtonte hapur idenë që Kosova të bëhej një njësi më vete brenda Jugosllavisë, krahas Serbisë dhe Malit të Zi. Programi i Partisë Radikale Serbe mbronte idenë se zgjidhja përfundimtare e çështjes së Kosovës do të krijonte një Republikë Serbe unitare dhe të fortë.<sup>43</sup> Procesi i centralizimit të fuqisë filloi me heqjen e statusit të autonomisë të Kosovës e Vojvodinës dhe vazhdoi me ndjekjen e një zgjidhjeje ushtarake për problemin e Kosovës.<sup>44</sup> Në heshtje, kjo zgjidhje e Serbisë u inkurajua nga mënyra si u manovrua me çështjen e Bosnjës, e cila transmetoi nga njëra anë ngurrimin e diplomacisë ndërkombëtare për të bërë ndonjë veprim që mund të rrezikonte bashkëpunimin e Milosheviçit për vënien në jetë të Marrëveshjes Dayton. Nga ana tjetër, diplomacia ndërkombëtare kërkonte përmirësimin e gjendjes të të drejtave të njeriut në Kosovë.

Përmirësimi duhej të ishte në atë masë, sa t'u siguronte shqiptarëve kontroll më të mirë mbi fatin e tyre dhe t'i jepte fund atmosferës shtypëse. Me fjalë të tjera, kjo nënkuptonte njohjen e të drejtës së shqiptarëve në Kosovë për vetëvendosje të brendshme, e cila do të inkurajonte shpresat e tyre për vetëqeverisje. Pas Marrëveshjes Daytonit, Ibrahim Rugova, presidenti i Republikës së Kosovës së vetëshpallur, vazhdoi me politikën e tij paqësore të negociatave. Me ndërmjetësimin e Urdhërit Sant'Egidio të besimit katolik me bazë në Romë, u bë progres në zhvillimin e një agjende për reformën arsimore. Kjo përpjekje përfundoi me nënshkrimin e një marrëveshjeje midis Milosheviçit dhe Rugovës, në 1 shtator 1996, mbi rifutjen e gjuhës shqipe në sistemin arsimor të Kosovës. Një veprim tjetër ishte heqja e vizave hyrëse në

<sup>40</sup> E. Hasani, *Self-Determination ...*, f. 242.

<sup>41</sup> S. Troebst, “Conflict in Kosovo ...”, f. 08.

<sup>42</sup> Naša Borba, cituar në “Kosovo after Dayton Agreement”, *Balkan Peace Team*, April-May 1996, f. 27-28. at <http://www.peacebrigades.org/bpt/bpt96-06.html>.

<sup>43</sup> Po aty, f. 6.

<sup>44</sup> W. J. Thies, “Compellence ...”, f. 248.



Shqipëri për shqiptarët e Kosovës. Për më tepër, gjatë marsit dhe prillit të vitit 1996, në New York dhe në Ulqin, nisën disa bisedime jo formale midis opozitës serbe dhe udhëheqjes kosovare.<sup>45</sup>

Marrëveshja e nënshkruar mbi gjuhën shqipe në sistemin arsimor të Kosovës<sup>46</sup> jo vetëm nuk u vu në jetë, por në provincë u shfaqën bastisjet nga ana e forcave para-ushtarake serbe. Të drejtat e njeriut nuk njohën ndonjë përmirësim, përkundrazi u përkeqësuan. Në raportin special të Ekipit të Paqes në Ballkan, “Kosova pas Marrëveshjes Dayton,” mars-prill 1996, u evidentuan dhunime të së drejtave të njeriut. Kështu, Këshilli i Mbrojtjes së Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Prishtinë, raportonte se vetëm në muajin mars 1996, ishin keqtrajtuar dhe torturuar 839 shqiptarë nga policia serbe. Në muajin shkurt 1996, vlerësohej të kishte më shumë se 250 raste. Gjatë muajit prill, ishin keqtrajtuar 711 shqiptarë. Vetëm në komunën Stimlje, ishin keqtrajtuar 122 persona, 116 familje u ishte bërë kontroll dhe 129 persona ishin thirrur për të dëshmuar në rajonin e policisë. Dhunimet e të drejtave të njeriut, nga ana e autoriteteve serbe kundër shqiptarëve të Kosovës pas Marrëveshjes në Dejton, u raportuan në seancën e 52-të të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut.<sup>47</sup>

Me qëndrimin e saj diplomacia ndërkombëtare u jepte palëve në konflikt të nënkuptonin mesazhin se lufta ishte mjeti i vetëm për arritjen e qëllimeve dhe interesave të tyre madje duke përdorur diplomacinë ndërkombëtare në mënyrë jo të drejtpërdrejtë.<sup>48</sup> Në këtë këndvështrim, Marrëveshja Dayton shënoi një pikë kthese në marrëdhëniet shqiptaro-

<sup>45</sup> Kosova International Center, 1997, f. 1-2.

<sup>46</sup> Craig Nation, “US policy and the Kosovo Crisis”, *International Spectator*, (October-December 1998).

<sup>47</sup> Më shumë mbi çështjen e dhunimit të të drejtave të njeriut në Kosovë mund të gjenden në: Human Rights Watch on Kosovo:

- *Persecution Persists: Human Rights Violations in Kosovo*, December 1996;

- *Human Rights Abuses of Non-Serbs in Kosovo, Sandzak and Vojvodina*, October 1994;

- *Open Wounds: Human Rights Abuses in Kosovo*, March 1994;

- *Abuses Continue in the Former Yugoslavia: Serbia, Montenegro and Bosnia-Herzegovina*, July 1993;

- *Human Rights Abuses in Kosovo*, October 1992;

- *Human Rights in a Dissolving Yugoslavia*, January 1991.

<sup>48</sup> Richard Caplan, “International Diplomacy and the Crisis in Kosovo,” *International Affaires* 4 (74), October 1998, f. 745-761.

serbe në Kosovë. Duke u përballur me këto zhvillime, zërat për radikalizim të rezistencës filluan të fitojnë terren ndër shqiptarët. Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) filloi operacionet kundër policisë serbe dhe oficerëve të ushtrisë duke marrë përsipër përgjegjësinë për sulmet mbi objektivat e ushtrisë serbe. Në prill 1996, UÇK-ja bëri lëvizjen e saj të parë, duke vepruar në katër vende të ndryshme: Pejë, Stimlje, Deçan dhe në rrugën Kosovë-Mitrovicë-Pejë, ku u vranë 5 serbë. Veprimi u publikua në një komunikate drejtuar seksionit në shqip të BBC. Grupi ushtarak deklaroi se “veprime të tilla do të ishin një paralajmërim për botën, për mbështetjen e dhënë agresionit serb, ndërkohë që shpërfillej vullneti i popullit të shtypur të Kosovës (...). Lufta e popullit të Kosovës nuk është terrorizëm, konflikt ndëretnik apo konflikt ndërfeetar, por një luftë për çlirimin e Kosovës”.<sup>49</sup> Veprimtaria u bë më e dallueshme në vitin 1997 dhe më vonë gjatë vitit 1998 ajo u përhap pothuajse në gjithë territorin e Kosovës. Këto veprimtari mbështeteshin edhe nga intelektualë, të cilët ishin deklaruar kundër politikave gandtiste të Rugovës, si edhe ishin deklaruar në favor të “rezistencës civile aktive” kundër shtypjes serbe.<sup>50</sup>

Ndërkohë, në shkurt 1998, autoritetet serbe nisën në shkallë të gjerë një seri operacionesh kundër popullsisë shqiptare dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.<sup>51</sup> Në mbështetje të operacioneve të autoriteteve serbe, në janar 1998, forcat paraushtarake dhe vullnetarë serbë, të njohur si “tigrat” e Arkan-it u kthyen në Kosovë për të terrorizuar popullsinë civile.<sup>52</sup> Nga këto operacione mbetën të vranë 400 persona dhe dhjetëra mijëra të tjerë u detyruan të lënë shtëpitë dhe fshatrat e tyre.<sup>53</sup> Në verën e vitit 1998, përshkallëzimi i konfrontimeve midis ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK-

<sup>49</sup> Shënimi më sipër *Kosovo after Dayton Agreement*, 22 Prill 1996.

<sup>50</sup> Rexhep Qosja, *La Question Albanaise*, Paris: Fayard, 1995; Veton Surroi, “Mehrheit und Minderheit in Kosovo: Albaner contra Serben”, *Internationale Politik* 52 (10), 1997, f. 49-52.

<sup>51</sup> S. Troebst, “Conflict in Kosovo ...”; Jeffrey Smith, “Yugoslavia Will Pay a Price, Albright Warns,” *Washington Post*, 9 March 1998, f.13.

<sup>52</sup> *The Economist*, “Arkan, Perhaps Sighted, Surely Wanted”, 31 January 1998.

<sup>53</sup> R. Caplan, “International ...”; Colin Soloway, “Serbia Attacks Ethnic Albanians”, *Washington Post*, 06 March 1998; Jeffrey Smith, “Eerie Quiet Follows Assaults in Kosovo”, *Washington Post*, 9 March 1998; Ivo Daalder and Michael O’Hanlon, *Winning Ugly: NATO’s War to Save Kosovo*, Washington: Brookings Institute, 2000.



së u bë më i dendur dhe në dimrin e 1998-1999, një përshkallëzim i ri shkaktoi në mars 1999 ndërhyrjen ushtarake të NATO-s.

Sipas Troebst, Marrëveshja Dayton shkaktoi ndryshime në strukturën e “pushtetit paralel,” e cila u përvijua në tre rrymat kryesore që i dhanë jetë tre grupimeve politike: pacifistët, aktivistët dhe ushtarakët.<sup>54</sup> Këto ndryshime nxitën zhvillime të rëndësishme në konceptimin politik të çështjes së Kosovës. Pikërisht, pas Dayton, shumica e shqiptarëve të Kosovës synonin pavarësinë e plotë.<sup>55</sup> Për të dyja palët si për serbët, ashtu edhe për shqiptarët, radikalizimi i qëndrimeve dhe përjashtimi reciprok i zgjidhjeve paqësore, e bënë të qartë se palët duhet të shkonin në luftë për të mbrojtur alternativat e tyre.

### **Diplomacia parandaluese: Bisedimet në Rambouillet (1998-1999)**

Diplomacia parandaluese ishte etapa vijuese, e cila përmbylli përpjekjet e diplomacisë ndërkombëtare për gjetjen e një zgjidhjeje paqësore për çështjen e Kosovës, përpara ndërhyrjes ushtarake të trupave të NATO-s. Në këtë fazë, për herë të parë ndërhyrja e diplomacisë ndërkombëtare ishte specifike pasi ajo u mor në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të hollësishme me palët në konflikt. Udhëzimet apo rekomandimet e diplomacisë ndërkombëtare më parë i kishin trajtuar në mënyrë të diferencuar shqiptarët e Kosovës në krahasim me minoritetet e tjera të ish-Jugosllavisë. Sipas këndvështrimit të Caplan ky diferencim:

I nevojshëm apo jo, ka ndihmuar për të siguruar që Kosova nuk do të bëhej një shqetësim ndërkombëtar, duke bërë të mundur që konflikti “të digjej në vetvete pa flakë” për vite të tëra. Sot, jemi dëshmitarë se shpërthimi i zemërimit është vetëm një pasojë e këtyre veprimeve. Një tjetër pasojë është se mundësia për një zgjidhje të matur është ngushtuar. Demokratizimi i vërtetë i Serbisë mund të zgjeronte hapësirën politike të nevojshme për të rivendosur besueshmërinë për një zgjidhje me kompromis, por perspektivat për një zhvillim të tillë afatshkurtër janë të dobëta.<sup>56</sup>

<sup>54</sup> S. Troebst, “Conflict in Kosovo ...”; Gazmend Pula, “Modalities of Self-Determination - The Case of Kosova as a Structural Issue for Lasting Stability in the Balkans”, *Sudosteuroopa*, 45, 1996, f. 380-410.

<sup>55</sup> W. J. Thies, “Compellence ...”, f. 247.

<sup>56</sup> R. Caplan, “International ...”, f. 745.

Marrëveshjet e ofruara nga diplomacia ndërkombëtare, si zgjidhje ndaj procesit të shpërbërjes së Federatës Jugosllave patën ndikime në formësimin e karakteristikave të çështjes së Kosovës dhe në të njëjtën kohë mund të perceptohen edhe si “shkëndijë” për rritjen e kundërshtive midis palëve në konflikt. Që nga viti 1998 e në vazhdim, situata në Kosovë u përshkallëzua në drejtim të përplasjeve të dhunshme ndonëse u ndërmoren një sërë përpjekjesh ndërkombëtare për të ndaluar konfliktin e armatosur. Përpjekja e fundit përpara së të shpërthente lufta ishte Konferenca e Paqes në Rambouillet shkurt-mars 1999.

Në shkurt 1998, Shtetet e Bashkuara të Amerikës morën nismën për të zgjidhur situatën me mjete diplomatike, siç dëshmon dhe dërgimi i Robert Gelbart, i dërguar i posaçëm për implementimin e Marrëveshjes Dayton, për të biseduar me Milosheviçin. Duket se Milosheviçit iu ofruan dy mundësi: të tregojë konstruktiv në gjetjen e zgjidhjeve të duhura për problemin e Kosovës ose të ndëshkohej më anë të sanksioneve të tjera dhe izolimit.<sup>57</sup> Nga ana tjetër, duke përkufizuar UÇK-në si “një grup terrorist”<sup>58</sup> dhe duke vlerësuar publikisht Milosheviçin, pa dyshim Gelbart u dha në dukje legjitimitet politikave të tij. Deklaratat e Gelbart ishin në përputhje me justifikimet e regjimit të Beogradit, i cili fajësonte për gjithçka që kishte ndodhur veprimtarinë irredentiste apo terroriste të UÇK-së.

Në përpjekje për të ndërtuar marrëdhënien shkak-pasojë të deklaratës, shkak i konfliktit i ngarkohej veprimeve terroriste të UÇK-së. Ky gjykim mbi çështjen inkurajoi shtimin e përdorimit të dhunës nga pala serbe. Mbështetur në një interpretim simplist të ligjit ndërkombëtar ajo i dha vetes të drejtë të merre të gjitha masat e nevojshme për t'i dhënë fund një veprimtarie të emërtuar si irredentiste apo terroriste brenda territorit të saj. Ky qëndrim përputhej më së miri me justifikimin e dhënë nga qeveria serbe, që më vonë u formalizua në dokumentin e titulluar “Terrorizmi në Kosovë dhe Metohi”. Në këtë dokument shkruhej se “terrorizmi shqiptar i orientuar drejt përzënies nga Kosova dhe Metohia të popullive serbe dhe joshqiptare ka zgjatur për vite duke synuar krijimin e territoreve të pastra etnike në Kosovë dhe Metohi, si

<sup>57</sup> I. Daalder and M. O'Hanlon, *Winning Ugly ...*, f. 27.

<sup>58</sup> Robert Gelbart, “*Press Conference*”, Zagreb, 23 tetor 1998.



dhe ka promovuar shkëputjen e kësaj krahine.”<sup>59</sup> Kartat e irredentizmit dhe terrorizmit, ndaj të cilave diplomacia ndërkombëtare ka pak gjasa të tolerojë, u përdorën nga Milosheviçi si një maskim për të vazhduar fushatën e dhunës në Kosovë. Autoritetet serbe gjetën tek veprimtaria e UÇK-së një pretekst legjitim për masa brutale të paligjshme ndaj popullsisë shqiptare të provincës. Veprime të tilla u inkurajuan nga Milosheviçi sipas Shkëlzen Maliqit<sup>60</sup> me qëllim provokimin e një kryengritje të gjerë shqiptare, me qëllim justifikimin e gjenocidit dhe spastrimit etnik të shqiptarëve që do të pasonte. Në fillim të shkurtit, Milosheviçi duket se ja doli mbanë në rivendosjen e besueshmërisë në lidhje me drejtësinë e politikave të tij ndaj çështjes së Kosovës.

Në këtë terren, palët reagues ndaj këtyre perceptimeve. Një seri sulmesh nisën kundër fshatrave shqiptare, ku pati viktime ndërmjet tyre edhe fëmijë e të moshuar. Sipas shumë vëzhguesve, politika e “tokës së djegur” u përdor për të detyruar shqiptarët e Kosovës të largoheshin nga shtëpitë dhe fshatrat e tyre.<sup>61</sup> Masakra e Drenicës, në fillim të marsit 1998, ku u vranë 80 shqiptarë të Kosovës, ndërmjet të cilëve 25 gra dhe fëmijë, shënoi fillimin e shtatë muajve luftë të hapur midis shqiptarëve të Kosovës dhe shtetit serb. Brutaliteti i veprimeve të serbëve në Kosovë bëri të qartë, siç pohon studiuesi Craig Nation, se “tashmë shtypja serbe nuk interpretohet vetëm si një reagim i tepruar ndaj një kryengritjeje të brendshme, por si një fushatë gjenocidi ndaj popullsisë shqiptare në tërësi”.<sup>62</sup> Më 9 mars 1998, në vijim të këtyre zhvillimeve u mblodh Grupi i Kontaktit i përbërë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia. Grupi i Kontaktit dënoi ushtrimin e dhunës dhe kërcënoi me vendosjen e embargos së armëve dhe sanksioneve të tjera të forta ndaj Beogradit, nëse serbët nuk ndalonin

<sup>59</sup> *Terrorism in Kosovo and Metohia and Albania - The White Book*, Belgrade: Federal Ministry of Foreign Affairs. At <http://www.serbia-info.com/news/kosovo/terrorism/terrorism.html>. (1998).

<sup>60</sup> Shkëlzen Maliqi, “Beyond Drenica, Crisis of Kosova”, *Transitions* 5 (4), Prill 1998.

<sup>61</sup> Jeffrey Smith, *vep. cit.*; C. Soloway, “Serbia Attacks ...”; Chris Stephen, “Kosovo under Second Day of heavy Serb Assault”, *Washington Post*, 07 Mars 1998; I. Daalder and M. O’Hanlon, *Winning Ugly ...*.

<sup>62</sup> C. Nation, “US policy ...”, f. 4.

sulmet e tyre në Kosovë, nuk tërhiqnin forcat e tyre paraushtarake dhe nuk lejonin vëzhgues të jashtëm të monitoronin situatën.<sup>63</sup>

Më 31 mars 1998, nëpërmjet Rezolutës 1160, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) formalizoi paralajmërime serioze për të dy palët, për qeverinë serbe dhe për udhëheqjen e shqiptarëve të Kosovës. Rezoluta 1160 dënonte në të njëjtën kohë atë që ajo e quante “terrorizmin e UÇK-së ose të ndonjë grupi apo individit, si dhe të gjithë mbështetjen e jashtme financiare me armë apo stërvitje ndaj veprimtarisë terroriste në Kosovë”, dhe “ushtrimin e tepërt të forcës nga forcat policore serbe kundër civilëve dhe demonstruesve paqësorë në Kosovë.” Rezoluta u kërkoi palëve “të hynin urgjentisht dhe pa kushte paraprake në një dialog kuptimplotë mbi çështjet politike të statusit” me “pjesëmarrjen e një përfaqësuesi apo disa përfaqësuesish të jashtëm”, pasi në rast të kundërt “do të merreshin masa shtesë”.<sup>64</sup> Megjithatë, prapa kërcënimeve për masa shtesë nënkuptojë kryesisht rivendosja e sanksioneve. Në rastin e Bosnjës, rivendosja e sanksioneve tregoi mungesë efektiviteti në ndryshimin e politikave serbe apo në dobësimin e Milosheviçit, së paku deri në momentin e ndërhyrjes ushtarake. Sipas studiuesit Wallace Thies “precedenti i Bosnjës sugjeron që sanksionet nuk do të funksiononin mjaftueshëm shpejt për të parandaluar serbët nga dhunimi i civilëve shqiptarë në Kosovë.”<sup>65</sup> Në fakt, sanksionet vërtetuan të ishin jo efektive, pasi ato nuk shprehnin një angazhim serioz për përdorimin e forcës si një zgjidhje alternative në rast të paefektshmërisë së politikës së sanksioneve. Thies, do ta përshkruante kështu gjendjen e krijuar:

Çdo paralajmërim apo kërcënim i lëshuar nga një përfaqësues i SHBA-ve ose nga një vend tjetër i NATO-s, përgjatë mars-qershorit 1998, është pasuar nga veprime të reja ushtarake të serbëve, të cilat pasoheshin nga kërcënime të tjera boshe. Në verën e vitit 1998, serbët në mënyrë të vazhdueshme treguan se kërcënimet e SHBA-së dhe të aleatëve të saj të NATO-s, mund të injoroheshin pa problem.<sup>66</sup>

<sup>63</sup> Anne Swadson, “Russia Agree on Sanctions for Belgrade”, *Washington Post*, 10 March 1998, f. 29; William Drozdiak, “West Vows New Sanctions on Yugoslavia”, *Washington Post*, 26 March 1998, f. 26.

<sup>64</sup> Rezoluta 1160 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, (31 Mars 1998).

<sup>65</sup> W. J. Thies, “Compellence ...”, f. 249.

<sup>66</sup> Po aty, f. 252.



Si rrjedhojë në prill të 1998, situata në Kosovë filloi të përkeqësohej përsëri. Siç do ta përcaktonte situatën "The Economist" "kur numri i të vdekurve u shtua dhe shqiptarët e Kosovës kapërcyen malet drejt Shqipërisë për armë, është e vështirë të mohohet ajo që tashmë duket qartë: një tjetër luftë ballkanike, ndonëse me intensitet të ulët, ka filluar".

Në 23 shtator 1998, Rezoluta 1199 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara kërkoi armëpushim të menjëhershëm dhe rikthim të refugjatëve në shtëpitë e tyre. Rezoluta 1199 ishte më ekstreme në formulimin e kërcënimeve krahasuar me Rezolutën 1160. Rezoluta kërcënonte se "masa shtesë dhe veprime të posaçme do të merren në konsideratë", duke nënvizuar si të tillë përdorimin të veprimeve ushtarake nëse konsiderohej e nevojshme, megjithëse deklarata nuk ishte shumë e qartë në këtë drejtim. Të dyja rezolutat të mbështetura nga Rusia (Kina abstenoj) rivendosën embargon ndaj Jugosllavisë dhe kërkuan armëpushim, si dhe gjetjen e një zgjidhje në përputhje me ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon, çka në fjalorin e diplomacisë ndërkombëtare, nënkuptojnë para së gjithash ruajtjen e kufijve të njohur ndërkombëtarisht.

Mbështetur në vendimet e Rezolutës 1199, filluan negociatat ndërmjet Milosheviçit dhe Richard Holbrook-ut, të dërguarit të posaçëm të Shteteve të Bashkuara. Diplomacia ndërkombëtare, me këmbënguljen e saj në ruajtjen e kufijve të Serbisë, ushqeu besimin se Kosova ishte një çështje e brendshme e Serbisë.<sup>67</sup> Këto mendime u transmetuan madje edhe nga marrëveshja e papublikuar midis Milosheviçit dhe Richard Holbrook-ut, e cila u vlerësua të ishte në "harmonji me Kushtetutën e Republikës së Serbisë dhe Jugosllavisë".<sup>68</sup> Milosheviçi pranoi marrëveshjen mbi armëpushimin, rikthimin e refugjatëve dhe arritjen e një marrëveshjeje mbi elementet thelbësore për një zgjidhje politike në Kosovë. Zbatimi i marrëveshjes do të vëzhgohej nga OSBE-ja. Marrëveshja u refuzua nga UÇK-ja sepse nuk ishte ftuar të bëhej pjesë e negociatave. Çështja e negociatave ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të

<sup>67</sup> Noel Malcolm, *Kosovo: A Short History*, London: Macmillan Press, 1998; Warren Zimmerman, "The Demons of Kosovo," *The National Interests* 52 (3), Spring 1998.

<sup>68</sup> Slobodan Milosevic, "Interview to the *Washington Post*", Serbia in the World, Special Supplement, Belgrade: The Ministry of Information of the Republic of Serbia, November 1998.

Kosovës ishte e komplikuar për shkak të kushtëzimeve që të dyja palët i kishin bërë publike. Drejtuesit e Serbisë duke u frikësuar se ndërmjetësimi ndërkombëtar do të ishte në disavantazhin e tyre organizuan një referendum, duke pyetur popullin serb rreth prezencës së ndërmjetësuesve të huaj në negociatat për statusin e Kosovës. Shumica e serbëve refuzuan prezencën e ndërmjetësuesve të huaj në negociatat me Kosovën. Nga ana tjetër, drejtuesit e Kosovës për shkak të mungesës së besimit tek drejtuesit serbë refuzonin të hynin në negociata pa prezencën e ndërmjetësuesve të huaj. Për më tepër, UÇK-ja kërcënonte që çdo lloj marrëveshjeje me serbët pa garancinë e ndërmjetësuesve të huaj do të konsiderohej si tradhti dhe e dënueshme.<sup>69</sup>

Shumë shpejt, marrëveshja dështoi. Serbët rifilluan luftimet nën të ashtuquajturin *Operacioni Patkoi*, që në thelb synonte ndryshimin e ekuilibrit etnik në Kosovë.<sup>70</sup> Sipas Daadler dhe O'Hanlon: "sulmet do të përfshinin një brez të gjerë të territorit për spastrim në formën e patkoit, duke u zhvendosur nga verilindja poshtë në Perëndim dhe duke u kthyer mbrapa në juglindje të Kosovës, përgjatë kufijve të Shqipërisë dhe Maqedonisë". Gjithashtu, operacioni synonte zbrazjen e qyteteve të Prizrenit, Pejës dhe Prishtinës nga popullsia e tyre e madhe shqiptare.<sup>71</sup>

Janari i vitit 1999 solli një set tjetër përpjekjesh diplomatike të kombinuar me kërcënimin e përdorimit të forcës. Më 22 janar 1999, Grupi i Kontaktit miratoi një plan për të imponuar një zgjidhje politike, duke përfshirë përdorimin e forcës në qoftë se njëra nga të dyja palët, serbët ose shqiptarët, refuzonin të pranonin marrëveshjen. NATO u zotua për të mbështetur vendimet e Grupit të Kontaktit.

Më 6 shkurt 1999, filluan negociatat midis udhëheqjes serbe dhe udhëheqjes shqiptare, duke përfshirë edhe UÇK-në, e cila më përpara ishte cilësuar si një organizatë terroriste.<sup>72</sup> Ky ndryshim i qëndrimit të diplomacisë ndërkombëtare ndaj UÇK-së ishte i bazuar në dy faktorë. *Së pari*, brutaliteti dhe vijueshmëria e sulmeve serbe mbi shqiptarët dhe paaftësia e drejtuesve të Kosovës për t'iu kundërvënë kishin marginalizuar

<sup>69</sup> Z. Isakovic, "Diplomacy and ...".

<sup>70</sup> Michael Ignatieff, *Virtual War. Kosovo and Beyond*, New York: Henry Holt & Company, 2000; I. Daadler and M. O'Hanlon, *Winning Ugly ...*; Alex J. Bellamy, *Kosovo and International Society*, New York: Palgrave Macmillan, (2002).

<sup>71</sup> I. Daadler and M. O'Hanlon, *Winning Ugly ...*, f. 59.

<sup>72</sup> Tim Judah, *Kosovo: War and Revenge*, Yale University Press, 2000.



Ibrahim Rugovën, përkrahësi i rezistencës jo të dhunshme. Shumë nga mbështetësit e tij u bashkuan me UÇK-në. Në fund të vitit 1998, UÇK-ja ishte një lëvizje e mirëorganizuar, me një staf gjeneralësh ushtarakë dhe me një kryesi politike civile. Kryesia drejtohej nga Hashim Thaçi, komandanti i UÇK-s, i cili mori pjesë në bisedimet e paqes në Rambouillet. Me këto zhvillime UÇK-ja u bë brenda Kosovës forca më e rëndësishme e rezistencës ndaj agresionit serb me mbështetje të gjerë popullore dhe legjitimitet ndërmjet shqiptarëve.<sup>73</sup> Së dyti, marrja e UÇK-së si palë në negociata “rriste koston e dhunës së Milosheviçit në Kosovë duke i dhënë atij më shumë stimuj për të negociuar një zgjidhje të pranueshme për NATO-n”.<sup>74</sup> Në këto rrethana, UÇK-ja nuk mund të lihej jashtë nga marrëveshja politike e Rambouillet.

Teksti i parë i bisedimeve në Rambouillet, i cili iu paraqit palës shqiptare dhe asaj serbe kishte pesë pika kryesore: ndalimin e menjëhershëm të dhunës; tërheqjen nga Kosova të ushtrisë, policisë dhe forcave parashtarake serbe; vendosjen e një force ushtarake ndërkombëtare të kryesuar nga NATO; rikthimin e sigurt të refugjatëve dhe popullsisë së shpërngulur në shtëpitë e tyre; një zgjidhje politike për autonomi të zgjeruar të Kosovës. Të dyja palët e kundërshtuan marrëveshjen. Serbët kundërshtuan prezencën e trupave të huaj në territorin e tyre, sepse për Serbinë, Kosova konsiderohej si çështje e saj e brendshme. Shqiptarët kundërshtuan mundësinë e një autonomie të zgjeruar, një status të cilin Kosova e kishte me Kushtetutën e vitit 1974. Në arsyetimin e shqiptarëve të Kosovës, zhvillimi i situatës në terren e kishte përjashtuar këtë alternativë. Dhjetë vjet shtypje që kishin kulmuar në veprime të dhunshme kishin bindur praktikisht të gjithë shqiptarët e Kosovës, se nuk mund të qëndronin në të njëjtin shtet me serbët. Rrjedhimisht, alternativa e pavarësisë ishte zgjidhja e vetme e pëlqyer nga i gjithë spektri politik i shqiptarëve të Kosovës.<sup>75</sup>

Negociatat rifilluan në 15 mars 1999. Teksti i ri i negociatave ofronte një zgjerim të autonomisë, që supozonte vetëqeverisje demokratike për të gjitha çështjet e brendshme, të tilla si edukimi, shëndetësia dhe ekonomia. Kosova do të kishte Presidentin dhe Asamblenë e saj.

<sup>73</sup> James Anderson and James A. Phillips, “The Kosovo Liberation Army and the Future of Kosovo”, *The Heritage Foundation*, 13 May 1999.

<sup>74</sup> Po aty.

<sup>75</sup> Patrick Moore, “Albanians With Whom One Can Talk” *RFE/RL Balkan Report* 4 (88), 15 December 2000, f. 88.

Marrëveshja do të garantohej nga trupa dhe zyrtarë të huaj. Autonomia e zgjeruar do të ofrohej përkohësisht, për një periudhë tre vjeçare. Gjatë kësaj periudhe parashikohej të mbahej një konferencë ndërkombëtare për të vendosur për statusin përfundimtar të Kosovës.<sup>76</sup> Megjithatë, në thelb të marrëveshjes ruhej integriteti territorial dhe sovraniteti i Serbisë.

Pala shqiptare e nënshkroi marrëveshjen, ndërsa serbët e refuzuan atë. Bisedimet dështuan në gjetjen e një zgjidhjeje paqësore. Ndërkohë zhvillimet në terren tregonin një përkeqësim të situatës humanitare. Dhjetëra mijëra njerëz filluan të braktisin shtëpitë e tyre përballë një ofensive të gjerë nga ana e forcave të armatosura serbe. Kjo u konsiderua si *causis belli* dhe i hapi rrugë përgjigjes ushtarake të NATO-s “*Operation Allied Force*”. Në përfundim të ndërhyrjes ajrore, vendimet e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 më 10 qershor 1999, do të shënonin në dukje fillimin e një periudhe të re për çështjen e Kosovës, por që në praktikë do të ishte një përpëlitje pothuajse 10 vjeçare në kërkim të një *modus vivendi* për të tejkaluar kuadrin normativ tradicional që vazhdon edhe sot të dekurajojë vetëvendosjen territoriale.

### Përfundime

Praktika ndërkombëtare në raste të konfliktit brenda shtetit, si ai i Kosovës, mbart probleme. Konfliktet brenda shtetit përfaqësojnë një anomali në kuadrin normativ tradicional të rendit ndërkombëtar. Ashtu siç tregoi rasti i Kosovës, koncepti i qendëruar tek sovraniteti dhe paprekshmëria territoriale e shtetit zbuluan të ishin të dëmshme, pasi për hir të tyre u sakrifikuan vlerat njerëzore. Përpjekjet ndërkombëtare për të ruajtur sistemin normativ ekzistues me anë të politikës së mosnjohjes<sup>77</sup> mund t’i japin vlerë luftës, në qoftë se pretendimet e grupeve të ndryshme etnike për vetëvendosje ballafaqohen me shtypje dhe dhunime të vazhdueshme. Lufta rrezikon të bëhet një kërcënim për rendin ndërkombëtar duke prekur jo vetëm shtetin në fjalë, por të gjithë vendet e rajonit. Përpjekjet për të ruajtur rendin mund të prodhojnë efekt të kundërt, domethënë luftë dhe mungesë rendi.

<sup>76</sup> Thanos M. Veremis and Dimitros Traintaphyllon, eds., *Kosovo and the Albanian Dimension in Southeastern Europe: The Need for Regional Security and Conflict Prevention*, Athens: ELIAMEP, 1999, f. 261-330.

<sup>77</sup> Steven Majstorovic, “Autonomy of the Sacred: The End Game in Kosovo”, *Nationalism and Ethnic Politics* 5, 1999, f. 3-4.



Sipas George White “njohja e të drejtës së një kombi tjetër për pavarësi mund të mos jetë parimisht problemi; njohja refuzohet për të parandaluar një problem akoma më të vështirë: Cili komb merr cilin territor si pjesë të deklaratës së pavarësisë?”.<sup>78</sup> Në kuadrin e sotëm normativ, përgjigja është e përcaktuar në termat *uti possidetis*. Aplikueshmëria e këtij parimi ka për qëllim të kundërshtojë argumentet ndarëse bazuar në etninë dhe identitetet përjashtuese. Një kuptim i botës me “shtetet duke vepruar si fortesa për identitetet përjashtuese në mënyrë reciproke” dhe “sovrانيتetin si themelin e marrëdhënieve shoqërore ndërmjet tyre”<sup>79</sup>, në praktikë është çorientues, pasi nuk merr parasysh pasojat e veprimeve të shtetit mbi popullin e tij.<sup>80</sup> Për më tepër, ky kuadër frymëzon Serbinë të vazhdojë politikën e mosnjohjes së pavarësisë së Kosovës madje të bëjë të gjitha përpjekjet për anulimin e saj.

Kuadri normativ tradicional mbetet përjashtues dhe përjetëson modelet e shfrytëzimit, tjetërsimit apo diskriminimit që krijojnë burime për konflikt<sup>81</sup>, dhe si pasojë krijojnë premisa për prishjen e rendit ndërkombëtar. Rasti i Kosovës vazhdon të sjellë prova të larmishme në mbështetje të këtij argumenti. Edhe sot, mosnjohja e pavarësisë së Kosovës nga Serbia, ambiguiteti dhe ngadalësia që ende shoqëron procesin e njohjes së pavarësisë së Kosovës me shumë gjasa mund t'i shtrojë rrugën një dështimi të ardhshëm të diplomacisë ndërkombëtare për konsolidimin e shtetit të ri të Kosovës dhe me tej ruajtjes së paqes dhe stabilitetit në rajon.

<sup>78</sup> George W. White, *Nationalism and Territoriality. Constructing Group Identity in Southeastern Europe*, Oxford: Rowman and Littlefield Publishers, 2000, f. 2.

<sup>79</sup> B. Buzan, “From International ...”, f. 337-339.

<sup>80</sup> Bjorn Moller, “National, Societal and Human Security-A General Discussion with a Case Study from the Balkans”, *COPRI Working Papers* 37, 2000, f. 37.

<sup>81</sup> Ken Booth, “Human Wrongs and International Relations”, *International Affairs* 71 (1), Janar, 1995, f. 103-126; Andrew Linklater, “Neo-Realism in Theory and Practice”, e Ken Booth and Stive Smith (eds), *International Relations Theories Today*, Cambridge University Press, 1995.

### Summary

#### KOSOVA QUESTION AND INTERNACIONAL DIPLOMACI (1991-1999). PREDICTING THE CONFLICT

The arrangements offered by international community as solutions to Yugoslav dissolution process did significantly affect the development of the Kosovo/a conflict. These policies failed to produce consensus between the parties in conflict, instead, as the paper demonstrate, they played the role of a catalyst in the initiation of the conflict. This paper, by offering a detailed reconstruction of the process by which the international community tried to settle the Kosova case, demonstrates how the dynamics of the conflict interacted dynamically with international community attitude and policies towards the case. The paper discusses the attitude and policies of international community toward the Kosova case underlining its attachment to traditional prerequisites of international order instead of inherited causes of conflict. There are three important events that underline the interference of international community in the case of Kosova before the war: the Conference on Yugoslavia that followed up the creation of the Badinter committee, the Dayton Agreement and the Rambouillet Talks. These events are explained in details in three separate sections since they have immediate implications for the situation in Kosova and consequently for the development of the conflict. The analysis follow the logic of first, discuss the contribution of existing normative framework to models of international community behavior and their effects in the case of Kosova conflict following with the reaction of the conflicting parties towards offered arrangements. Both moments are assumed to be of importance in providing a larger picture in the understanding of the Kosova conflict outgrowth.

The international practice in the case of conflict such as the one of Kosova as it is argued throughout the paper appears to be increasingly controversial. Intra-State conflicts represent anomalies in the traditional normative framework where there is confusion as to the nature of the actors subject of protection and the relevance of domestic structures in the relations between the States and order in international relations. As the case of Kosova demonstrates, the States centric concept of authority and related practices revealed to be detrimental in the sense of scarifying other human values for those of sovereignty and territorial inviolability. Furthermore, international society by the policy of non-recognition denies the recognition to these new actors and turn down their claims to self-determination. The international efforts to preserve this traditional normative framework as a prerequisite for



order could give forth war if claims of different ethnic groups for self-determination are faced with repression and deterioration of human rights. Furthermore, this war threatens to become a serious threat to order affecting not only the State in question but the countries of the region as well.